



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 81/2022

Prishtinë, më 29.11.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Armend Muja, Driton Hyseni dhe Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku–Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila dhe Abelard Tahiri, anëtarë.

E ftuar: znj. Artane Rizvanolli, ministre e Ministrisë së Ekonomisë (ME).

Pjesëmarrës tjerë: Agim Kukaj, ME; Rrezarta Duraku dhe Visar Halimi, ARKEP; Arianit Behrami, Kuvendi/Media; Festim Bytyçi, GP-AAK dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.11.2022;**
- 3. Shqyrtimi i Planit Kombëtar të Radio - frekuencave;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.11.2022

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 24.11.2022, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit Kombëtar të Radio - frekuencave

Kryetari theksoi se në bazë të nenit 6, paragrafi 2.1. të Ligjit nr.04/L-109 për komunikimet elektronike, dhe nenin 29 dhe 30, të Rregullores së Kuvendit, ka në shqyrtim Planin e Radio - frekuencave. Së pari ia kaloi fjalën ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli për ta arsyetuar këtë dokument strategjik dhe mandej hapim debat.

Znj. Artane Rizvanolli, ministre e Ministrisë së Ekonomisë (ME), duke prezantuar “Planin Kombëtar të Radio Frekuencave” theksoi se ky dokument është me rëndësi strategjike shtetërore. Plani është përgatitur në përputhje me Nenin 10, paragrafin 1 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, ku specifikohet që Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë përgatit Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave. Ky plan është një dokument themelor për shpërndarjen e radio frekuencave, me anë të së cilave mundësohet shfrytëzimi i spektrit për ofrimin e shërbimeve të radio komunikimeve. Spektri frekuencor dhe Radio komunikimet, përveç rëndësisë në zhvillimin e komunikimeve elektronike dhe zhvillimit ekonomik të vendit, kanë rëndësi të madhe edhe për aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nacionale, sigurinë nacionale, mirëmbajtjen e rendit publik, shërbimet publike emergjente, mbrojtjen e kufijve shtetërorë, aviacionin civil, sigurinë hekurudhore, operimin e sigurt dhe stabil të sistemit energjetik nacional, si dhe për funksionet tjera. Aktualisht në fuqi është versioni i Planit Kombëtar të Radio Frekuencave i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor të vitit 2011. Prandaj, hartimi i një Plani të përditësuar për radio frekuenca është i domosdoshëm. Plani Kombëtar i Radio - frekuencave është përgatitur për brezin frekuencor nga 8.3 kHz deri në 3000 GHz sipas rekomandimeve dhe vendimeve ndërkombëtare, tabelës evropiane të alokimit dhe aplikimeve të Frekuencave si dhe sipas nevojave kombëtare, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e përdoruesve dhe industrisë për shfrytëzimin sa më efikas të resurseve frekuencore. Plani Kombëtar i Radio Frekuencave ka kaluar në procesin e konsultimit publik, duke ua ofruar mundësinë palëve të interesit që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre. Gjatë periudhës së konsultimit publik të dokumentit Plani Kombëtar i Radio Frekuencave janë pranuar dhe në vijim janë analizuar dhe shqyrtuar komentet e pranuar nga operatorët. Sipas neni 6 paragrafi 2.1, të Ligjit të Komunikimeve Elektronike, Qeveria miraton Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe i propozon Kuvendit aprovimin e Planit. Prandaj, ju kërkoj juve si Komision që ta aprovoni Planin dhe të vazhdohet me procedura tjera në Kuvend.

Rrezarta Duraku, anëtare e bordit të ARKEP-it, shtoi se Plani është përgatitur në bazë të nenit 10 të ligjit për Komunikimet elektronike. Plani kombëtar i radio - frekuencave është një dokument strategjik i gjerë dhe teknik. Plani përcakton brezet frekuencore dhe kushtet bazë për dhënien në shfrytëzim të radio - frekuencave. Tutje ajo foli për ecurinë e hartimit të planit ku theksoi se

ARKEP-i ka punuar rreth një vit për hartimin e këtij plani. Ka pasur takime me institucione relevante. Po ashtu ka pasur konsultime publike rreth një muaj. Miratimi i këtij dokumenti i hap rrugë zhvillimit të resurseve radio - frekuencore.

Visar Halimi, shef i Drejtorisë për menaxhimin e radio- frekuencave - ARKEP, foli për çështjet teknike të Planit Kombëtar të radio - frekuencave. Rekomandimet e reja nga organet evropiane të radio - frekuencave kërkojnë përshtatjen për zbatimin e teknologjisë së re. Kemi bashkëpunim të mirë edhe me Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) dhe në breze frekuencore të caktuara është përfshirë edhe KPM. Gjatë hartimit kemi pasur konsultime me KFOR-in, FSK, dhe institucione tjera relevante.

Kryetari pyeti se sipas mendimit të juaj a kemi nevojë ne, si Komision të organizojmë debat me palë të interesit apo duhet ta procedojmë për miratim në seancë plenare. A mund të konstatojmë se Plani kombëtar për radio - frekuenca mbulon tërë territorin e Kosovës?

Visar Halimi, ARKEP, sqaroi se ne i kemi konsultuar të gjitha palët. Mund të organizoni debat por konsiderojmë se ndryshimet janë shumë të vështira me u bë në këtë plan. Komentet e palëve i kemi sqaruar gjatë diskutimeve me palët. Plani Kombëtar i Radio - frekuencave është për tërë territorin e Kosovës.

Armend Muja, pyeti si është trajtuar mbulueshmëria në veri të vendit nga Vala dhe IPKO? Vala dhe IPKO kanë pasur licencë për tërë territorin e Kosovës. Cilat masa i ka paraparë ARKEP-i për me i obliguar me mbuluar tërë territorin?

Visar Halimi, ARKEP, sqaroi se në Planin Kombëtar të Radio - frekuencave detaje të tilla nuk përfshihen. Në Plan përfshihen të gjitha shërbimet radio - frekuencore për të gjithë territorin e Kosovës. Me akte sekondare rregullohen çështjet lidhur me rrjetin dhe operatorët.

Rrezarta Duraku, ARKEP, theksoi se ARKEP-i ka organizuar takime me dy operatorët për me mbuluar edhe pjesën veriore, në mënyrë që të ketë bashkë shfrytëzim të pajisjeve. Ka pasur prezencë të pajisjeve në atë pjesë por janë dëmtuar. Takime kemi pasur edhe me ME edhe MPB, në përkrahje të këtyre dy operatorëve për shtrirje në këtë pjesë të rrjetit të telefonisë mobile.

Ministrja, potencoi se së bashku me operatorët dhe me MPB kemi filluar me punuar në këtë aspekt dhe puna është në rrugë të mirë.

Armend Muja, theksoi se për një brez frekuencor keni pasur konsultime me KPM. KPM-ja gjatë raportimeve ka theksuar se ka vështirësi për lirim të brezit të kontestuar të brezit radio - frekuencor. Çka është bërë në aspektin e lirimit të këtij brezi radio - frekuencor? Sigurimi i domenit të shtetëror të internetit ende nuk është bërë. Ku jeni me këtë çështje?

Visar Halimi, ARKEP, sqaroi se është e vërtetë që ka pak kapacitete frekuencore në KPM, ka diskriminim edhe nga organizata në Gjenevë. Problemi është se televizionet kombëtare në transmetim analog, ende nuk kanë kaluar në transmetim digjital kabllor, në mënyrë që KPM ta liron brezin 700 MHz.

Rrezarta Duraku, ARKEP, sqaroi se për domenin shtetëror të internetit kemi pasur takim me ambasadat e huaja, veçanërisht me ambasadën amerikane e cila ka premtuar të na ndihmojë, dhe jemi duke punuar në strategjinë që do të përdoret për marrjen e domenit në bashkëpunim të ngushtë me ambasadën amerikane.

Ministrja, sqaroi se ne kemi pasur disa takime për domenin shtetëror, kemi filluar aty ku ka mbetur para disa viteve. Janë disa rrugë për me arrite marrjen e domenit shtetëror të internetit. Kemi kërkuar asistencë teknike për me sqaruar më shumë rrugën të cilën do ta zgjedhim para se të shkojmë me procedura të aplikimit.

Driton Hyseni, theksoi se e presim Planin kombëtar të radio - frekuencave si një dokument strategjik të mirë për shfrytëzimin e resurseve radio - frekuencore. Mungesa e rifreskimit të këtij dokumenti nga viti 2012 a ka paraqitur ndonjë pengesë për zhvillim të spektrit radio - frekuencor? A kemi nevojë për dëgjim publik? Ju si ARKEP thatë se keni pasur konsultime me operatorë dhe institucione tjera. Ne kemi nevojë me ditë se operatorët konsiderojnë se ky plan përmbush kërkesat e tyre. Gjithashtu duhet të mos ketë interferime ndërkuftare nga jashtë me shtetet fqinje.

Rrezarta Duraku, ARKEP, theksoi se është një periudhë e gjatë që është punuar në këtë dokument, kryesisht ndryshimet janë në brezet frekuencore 700 dhe 800 MHz. Nuk do të thotë se me këtë dokument kryhet i tërë procesi. Për shembull nuk është bërë digjitalizimi i transmetimeve tokësore dhe për këtë nuk ka qenë problemi te Plani Kombëtar i Radio - frekuencave. Komente ka pasur pak për këtë dokument. Kemi marrë komente nga Telekom i Kosovës dhe IPKO dhe i kemi sqaruar çështjet me ta. Me miratimin e këtij plani i hapet rrugë ndryshimeve të nevojshme në shfrytëzim të radio - frekuencave. Interferimet nga Serbia, ato më tepër lidhen me monitorimin. Ka stacione monitoruese fikse edhe duhen stacione mobile të monitorimit.

Driton Hyseni, pyeti se vendosja e stacioneve monitoruese a na jep një pasqyrë të qartë për interferimet nga jashtë dhe ta adresojmë? Operatorët e tanishëm a janë zotuar për ngritjen e nivelit të kualitetit të shërbimit në tërë territorin e Kosovës, sepse në shumë zona nuk kemi mbulueshmëri me valë të telefonisë mobile?

Visar Halimi, ARKEP, theksoi se kemi stacione monitorimi fikse që do të thotë se është më vështirë të të monitorohen interferimet, me stacione mobile mund të monitorohen më mirë sepse mund të ofrohemi afër zonave kufitare. Interferimet kufitare tash janë më të vogla sesa më parë.

Rrezarta Duraku, ARKEP, theksoi se ARKEP-i ka punuar me dokumente përkatëse për hapjen e brezeve 800 Mhz dhe 3.4 deri 3.8Ghz. Ideja është promovimi i teknologjisë 5G. Ne kemi pranuar aplikacione nga dy operatorët që do të thotë se ka interesim për rritjen e kualitetit të shërbimeve.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Kryetari njoftoi se kam vizituar Ndërmarrjen Trepça në emër të Komisionit dhe kam marrë disa informacione për gjendjen, për planifikimet buxhetore dhe për sfidat që po kalon ndërmarrja Trepça. Mendoj që çështjet buxhetore për ndërmarrjen Trepça mund t'i diskutojmë gjatë mbledhjes së ardhme, ku do ta kemi seancën dëgjimore për buxhetin e vitit 2023.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit